

RAPORTI

MBI PUNËN E DREJTORATIT PËR EKONOMI FINANCA DHE ZHVILLIM PËR VITIN 2017

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim ,sa i përket strukturës organizative është i organizuar në këto njësi punuese:

1. Njësja punuese për Buxhet;
2. Njësia punuese per Financa
3. Njësia punuese e Tatimit në Pronë
4. Njësia punuese e Thesarit
5. Njësia punuese e Regjistrimit të Bizneseve
6. Njësia punuese për Ekonomi

Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim,në vitin raportues 2017, ka qenë e përqendruar në: përgatitjen e Projekt Buxhetit të komunës për vitin 2018-2020 i bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe Qarkoret buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave, hartimin e planit dinamik të realizimit të mjeteve buxhetore – të ashtu quajturin planin e rrjedhjës së parasë së gatshme, ofrimin e këshillave për zbatimin e drejtë të procedurave lidhur me ekzekutimin e buxhetit.

Punimin e raporteve të ndryshme lidhur me realizimin e buxhetit (muajore,tremujore dhe vjetore), realizimin e planit të inkasimit të të hyrave vetanake nga tatimi në prone dhe të hyrave tjera vetanake, regjistrimi dhe raportimi I të hyrave vetanake në SIMF – Fribalanc, hartimin e rregulloreve , koordinimi I aktiviteteve të ndryshme me Ministrinë e Financave dhe Thesarin

Të gjitha këto aktivitete të lartëshenuara mbështetjen ligjore e kanë në zbatimin e drejtë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin mbi Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin mbi Tatimin në Pronë, Udhëzimet dhe Rregulloret e ndryshme administrative.

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim bazuar në dispozitat e nenit 60 dhe 61 të Ligjit Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe Qarkoreve buxhetore ka përgadit projekt buxhetin për vitin 2018-2020 dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën në fjalë duke i respektuar afatet dhe procedurat e aprovimit të buxhetit. Procesi i ekzekutimit të buxhetit për vitin 2017 ka filluar nga mesi i janarit të vitit 2017 sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme.

Njësia punuese e financave – në kuadër të kësaj njësie punojnë 3 zyrtar. Kjo njësi veprimtarinë e saj e ka përqendruar në:

Pranimin e aktvendimeve dhe kontratave të ndryshme nga ana e noterit të komunës për bartje të patundshmërisë.

Ka lëshuar vertetime dhe certifikata të ndryshme për shlyerjen e obligimeve tatimore rreth pranimrreth pranim-refuzimit të shtetësisë së Kosovës.

Ka ndihmuar sektorin e tatimit në pronë rreth shpërndarjes së faturave, inkasim, regjistrim të objekteve të reja dhe verifikim të objekteve.

Ka përpiluar dhe lëshuar certifikata të ndryshme subjekteve afariste mbi përmbushjen e obligimeve komunale.

Ky sektor punën e vet e ka bazuar në rregullorën mbi taksat komunale 01.Nr.06-793/1 të datës 29.05.2013 dhe në bazë të kësaj rregullore ka lëshuar:

- Vertetime për bartje të pronësisë- 308
- Certifikata-vertetime të ndryshme për tendera nga bizneset -10
- Vertetimi-certifikata për pranim-refuzim të shtetësisë së Kosovës -91.

Gjatë vitit 2017 nuk kemi inkasuar para nga bartja e patundshmërive sepse me rregullorën e re të KK të Dragashit është bërë shlyerja e taksave për bartjen e pronës 26.09.2013. Sa I përket inkasimit për vitin 2017 ka qënë më I vogël se viti 2016 sepse qeveria ka bërë faljen e borgjeve, bizneset që nuk kanë qënë aktive kanë bërë qlajmërimin e tyre dhe biznest që kanë pasur borxhe, disa kanë bërë pagesën me keste ose dhe në tërësi.

Inkasimi për këtë vit ka qënë me I vogël sepse është miratuar rregullorja mbi lartësinë e taksave dhe borxheve 01.Nr.06.649/1 të datës 03.05..2012 në të cilën është parapa lirimi për 3 vite nga taksat komunale për bizneset e reja .

Më datën 31.05.2016 në kuvendin komunal është aprovuar rregullorja mbi lartësinë e taksave , ngarkesave dhe borxheve komunale Nr.01.06/8491/1 në të cilën është vendos: të gjitha bizneset individuale të cilat regjistrohen nga data 01.01.2016-31.12.2018 do të lirohen nga obligimi I pagesës së taksave në firmë.

Gjatë vitit 2017 kemi lidhur 43 kontrata me bizneset (36 nga viti 2016 dhe 7 nga viti 2017) për pagesë të borxheve me keste. Një numer I madhe I bizneseve nuk e kanë rrespektuar marrveshjen për pagesën e borxheve me keste. Në të ardhën do të mundohemi ti bindim që të bëjnë pagesën e borxheve

Njësia e tatimit në prone- Zyra e tatimit në pronë në Dragash është formuar në harmoni me ligjin mbi tatimet në patundeshmëri Nr.03/L-204 dhe Udhezimin Administrativ mbi Organizimin dhe funksionimin e zyreve të tatimit në pronë Nr.10/2011.

Detyra kryesore e zyrës është që për çdo vit të bëjë llogaritjen dhe fakturimin pronareve dhe shfrytezuesve të pasurive të patundëshme (objekte banesore, industrial,komerciale etj) shumat e tatimeve të cilat duhet të paguajnë për vitin e

caktuar, si dhe të ndërmërrë të gjitha masat rreth inkasimit sa më të madhë të tatimeve në pronë.

Zyra e tatimit në pronë ka këtë personel: menaxheri I tatimit në pronë, dy operator për futjen e shenimeve në kompjuter, dy shpërndarës të faturave dhe një anketues-gjeodet.

Gjatë vitit 2017 ka arritur këto rezultate:

- Kemi printuar dhe kemi shpërndarë 9773 faturave obliguese tatimore, shuma e të cilave sillet 218.441,47 euro. Mesatarja e faturave 22.36 euro
- Kemi bërë inkasimin e tatimit në pronë sipas Fribalancit në shumë 194.140,00 euro, prej kësaj shume 65.50,00 euro janë inkasuar nga aplikimi i ligjit mbi faljen e borxheve publike.
- Gjithsej kemi pranuar 45 ankesa nga qytetaret prej tyre 40 janë aprovuar dhe është vendos në favor të obliguesve tatimor, dhe 5 janë refuzuar si të pa bazuara ne ligj.
- Është bërë verifikimi i 1620 objekteve nëpër vendbanime te ndryshme në përqindje 17 %
- Janë regjistruar 215 objekte të reja
- Qytetareve për rëalizimin e të drejtave të tyre siq janë: regjistrimi i automjeteve, fletëparaqitje për pënsione, për ndihma sociale, vertetimi I kontratave të ndryshme, pranimi dhe kthimi I shtetësisë, subvencionet etj u janë lëshuar 4000 vertetime të ndyshme.

Njësia e Thesarit-është formuar me Udhëzimin Administrativ 02/2009 mbi delegimin e menaxhimit të shpenzimeve janë bartë funksionet e procesimit të shpenzimeve nga thesari rajonal në atë komunal..Në kuadër të kësaj njisije funksionojnë zyrtari zotues, zyrtari i procesimit të urdhër pagesave –zyrtari i shpenzimeve, zyrtari i të hyrave vetanake dhe zyrtari i parave të imta.

Zyrtari zotues në periudhën janar –dhjetor 2017 kanë pregadit 2.366 urdhër pagesa për shpenzim.Kujdes i veqant i është kushtuar mënyrës së drejtë dhe cilësore të përgaditjes dhe futjes së zotimeve në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar.

Zyrtari i shpenzimeve ka procesuarv 2362 urdhër pagesa, 4 urdher pagesa nuk jane certifikuar për këto arsye: 2 përfitues nuk kanë pasur llogari aktive, 1 nuk ka pasur mjete financiare dhe 1 gabim ne faturë

Zyrtari i të hyrave vetanake ka bërë regjistrimin e 250 raporteve të të hyrave vetanake,ka pregatit 50 fletëalokime, 13 barazime vjetore për të hyra vetanake, dhe ka bërë certifikimin e urdhër pagesave si punë shtesë (2362) dhe arkivimin e te gjitha dokumentave te thesarit.

Zyrtari i parave të imëta ka punuar në përgaditjen dhe terheqjen e parave nga banka ne vlerë 3.687,75 si dhe ka bërë pagesa me para të gatshme. Përveq kësaj ka pranuar nga zyrtaret paratë e inkasuara në vlerë 47.281.32 dhe të njejtat i ka deponuar në xhirollogarinë bankare të komunës.

Po kështu si punë shtesë, ka bërë dhe regjistrimin e pasurive me vlerë mbi 1000 euro në SIMF.

Njësia-zyrtari përgjegjës në qendrën komunale për regjistrimin e biznesit dhe lejeve të punës

Kjo njësi ka bërë dhënjën-lëshuarjen e lejeve të punës për subjektet afariste që i plotësojnë kushtet minimale higjieno-sanitare dhe teknike për punë: gjithsej 2 leje pune.Hartimin e kontratave dhe lëshuarjen e tyre për shfrytëzuesit e përkoshëm të tokës ndërtimore, jo ndërtimore sipas rregullorës 01.Nr.06-125/1 të datës 04.08.2009.Gjithsej: 45 kontrata

Lëshuarjen e certifikatave të ndryshme në lëminë e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë etj. Gjithsej: 25 Certifikata. Lëshuarjën e vërejtjeve për pagesë shfrytëzuesve të përkoshëm. Gjithsej 130. Janë bërë regjistrimeve të bizneseve të reja gjithsej 65, shuarje të bizneseve gjithsej 25, ndryshime në biznes 21 certifikata me logo RKS 10, lëshuarje të informatave të biznesit 50, gjithsej 171.

Është punuar në plotësimin e formulareve të ndryshëm për regjistrimin e bizneseve dhe janë dhënë konsulta të ndryshme në lëminë e biznesit në harmoni me ligjin Nr.02/L-123.

Është bërë vërtetimi i vijave për transportin urban, 2 transportuesit prej fshatit Restelicë deri Dragash dhe anasjelltas (Kabash Tours Prizren) dhe ERZA, Zapllugje-Dragash dhe anasjelltas.

Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim rregullisht në baza mujore dhe periodike ka paraqitur raporte mbi realizimin e buxhetit për vitin 2017.

Përveq aktiviteteve të paraqitura më lartë zyrtarët e këtijë drejtoratri dhe të drejtorateve tjera kanë qenë bashkpunues me auditorët të cilët në vitin 2017 kanë bërë auditimin e PVF për vitin 2016 dhe auditimin për periudhën janar-shtator 2017.

